



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA SUPREME**

---

Numri i lëndës: 2020:914651  
Datë: 29.04.2024  
Numri i dokumentit: 05632711

Rev.nr.172/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Beshir Islami, kryetar, Nenad Llaziq dhe Rustem Thaqi, anëtar, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B. K. nga fshati D., Komuna e R., të cilin me autorizim e përfaqëson Isa Salihi avokat nga P., kundër të paditurit Këshilli Gjyqësor i Kosovës me seli në P., të cilin me autorizim e përfaqëson B. M., për shkak të kompensimit të dëmit material dhe jo material, duke vendosur lidhur me revizionin e paditësit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.3507/2019, i datës 18.04.2023, në seancën e mbajtur më datë 25.04.2024, merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet, si i pabazuar, revizioni i paditësit B. K. nga fshati D., Komuna e R., i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ac.nr.3507/2019, të datës 18.04.2023.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Rahovec, C.nr.340/2014, i datës 13.02.2019, në pjesën I të dispozitivit, është refuzuar, si e pa bazuar, kërkesëpadinë e paditësit B. K. nga fshati D., Komuna e R., me të cilën ka kërkuar që të nulohet marrëveshja jashtë gjyqësore e lidhur në mes të paditësit dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës – P., e datës 17.04.2014. Nën pikën II të dispozitivit është refuzuar kërkesëpadia e paditësit, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituria, që në emër të kompensimit të demit material dhe jo material t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 240.673,00 €, me kamatë, si dhe ka refuzuar në tërësi si

të pathemeltë edhe për këto kritere të dëmit: në emër të dhimbjeve shpirtërore shumën prej 50.000 €, në emër të dhimbjeve shpirtërore të anëtarëve të familjes së ngushtë-bashkëshortes, tre djemtë dhe vajzës, për secilin shumën prej 10.000 €, në emër të cenimit të prestigjit dhe autoritetit dhe shqetësimit të paditësit shumën prej 100.000 €, në emër të shqetësimit të anëtarëve të ngushtë të familjes, për bashkëshorten, tre djemtë dhe vajzën e paditësit shumën për secilin anëtar nga 10.000 €, në emër të fitimit të munguar për 369 ditë në shumën e përgjithshme prej 3.321 €, në emër të pakos dhe shpenzimeve të vizitave në qendrat e paraburgimit shuma prej 10.000 € dhe në emër të shpenzimeve për mbrojtje penale nga avokati mbrojtës shuma prej 2.500 €. Nën pikën III të dispozitivit është vendosur që secila pale i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës , Ac.nr.3507/2019, të datës 18.04.2023, refuzohet si e pathemeltë, ankesa e paditësit B. K. nga fshati D., Komuna e R., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Rahovec, C.nr.340/2014, i datës 13.02.2019, vërtetohet.

Kundër aktgjykimin të gjykatës së shkallës së dytë, paditësi përmes të autorizuarit avokat Isa Salihi nga P., me kohë ka paraqitur revizion për shkak të shkeljeve esenciale të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që i njëjti aktgjykim të ndryshohet ashtu që paditësit t'i pranohet kompensimi i dëmit sipas kërkesëpadisë.

Pala e paditur nuk ka paraqitur përgjigje në revizionin e paditësit.

Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 215 të Ligjit për Procedurë Kontestimore (LPK) si dhe sipas pretendimeve të revizionit, shqyrtoi aktgjykimin e goditur me revizion, si dhe shkresat e lëndës, dhe gjeti se:

Revizioni i të autorizuarit të paditësit, është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, pretendon se me datë 17.04.2014 në P., është lidhur dhe nënshkruar Marrëveshja jashtëgjyqësore në mes të paditësit dhe të paditurit për dëmshpërblimi material dhe jo material nga baza juridike-heqje e të drejtës së lirisë, pa bazë ligjore, e cila marrëveshje është nënshkruar nga paditësi, duke qenë laik dhe nuk e ka kuptuar natyrën e kompensimit si dhe shumën e kompensimit , i cili nuk ishte i përfaqësuar nga avokati dhe në bazë të rrethanave të rastit nuk kishte njohuri se kompensimi për rastet e njëjta dhe rastet e tjera është më i lartë se në marrëveshjen e nënshkruar nga ai me të paditurin, andaj duke u gjendur në një situatë të lajthimit substancial siç parashihet me nenin 46 të LMD-së, ka kërkuar nga gjykata anulimin e Marrëveshjes jashtëgjyqësore të datë 17.04.2014 dhe të detyrohet i

padituri, për kompensimin e dëmit material dhe jo material, në shumat e kërkuara sipas precizimit të kërkesëpadisë me parashtrësën e datës 31.12.2018, për shkak të dëmtimit përtej mase dhe njohje të drejtës në dëmshpërblim material dhe jo material për shkak të heqjes së lirisë pa bazë ligjore.

Ka theksuar se nuk është kontestuese se i padituri, ka bërë kompensimin sipas marrëveshjes në shumën prej 5.148,00 €, ndërsa për vërtetimin e pretendimeve si në padi ka propozuar gjykatës marrjen e provave materiale nga lëmia e neuropsikiatrisë për të vërtetuar dhimbjet shpirtërore, si dhe nga lëmia e aktuaristikës për të vlerësuar fitimin e humbur për faktin se paditësi si bujk, gjatë kohës së heqjes së lirisë pa bazë ligjore, ka mbetur pa sigurimin e ekzistencës të familjes së tij, e që pas shqyrtimit të provave të propozuara ta aprovoj kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, në shumat e kërkuara me kamatë ligjore si dhe shpenzimet e procedurës

Gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në këtë gjendje të vërtetuar faktike, e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit për faktin se në këtë çështje konkrete juridike nuk është vërtetuar se paditësi është gjendur në situatë juridike të lajthimit substancial me rastin e nënshkrimit të Marrëveshjes jashtëgjyqësore të datës 17.04.2014, duke qenë se është vërtetuar se paditësi me kërkesën me numër protokolli ... të datës 04.04.2014, i është drejtuar të paditurit, nëpërmes të autorizuarit A. R., për kompensimin e dëmit material dhe jo material, për shkak të heqjes pa arsye të lirisë, ndërsa komisioni i të paditurit i ka dhënë ofertën e datës 14.04.2014, që më pastaj paditësi dhe i padituri kanë nënshkruar marrëveshjen me datë 17.04.2014, e cila sipas urdhërpagesës së datë 30.04.2014, është vërtetuar se e ka bërë ekzekutimin e shumës prej 5,148.00 €, në emër të kompensimit të paditësit, çka nuk ishte kontestuese, dhe se mbi këtë bazë ka konsideruar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 46 të LMD-së, që të detyrohet i padituri për anulimin e marrëveshjes jashtëgjyqësore të datës 17.04.2014 dhe pastaj kompensimin e dëmit material dhe jo material, në të cilin pretendon paditësi.

Pikëpamjen juridike të Gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj, e aprovon në tërësi edhe Gjykata e Apelit, sepse aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu ky aktgjykim nuk është i përfshirë as me shkelje të tjera të dispozitave të

procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaftë i qartë, i kuptueshëm, nuk është në kundërtënie me vet veten ose me arsyet e aktgjykimit si dhe arsyetimi përmban arsye të mjaftuara bindëse faktike dhe juridike vendimtare për të vendosur në këtë çështje juridike. Po ashtu gjykata e shkallës së parë rregullisht dhe në tërësi e ka vërtetuar gjendjen faktike e cila nuk vihet në dyshim me pretendime ankimore dhe kështu kishte një pasqyrë reale mbi gjendjen e çështjes në këtë çështje juridike. Në këtë gjendje faktike të vërtetuar tërësisht dhe rregullisht nga ana e gjykatës së shkallës së parë, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale të cilin shkak ankimor e vlerëson gjykata e shkallës së dytë në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e Apelit ka vlerësuar se me provat e administruara nga gjykata e shkallës së parë, është vërtetuar se paditësi me të paditurin ka lidhur marrëveshjen-ujdinë jashtëgjyqësore me datë 17.04.2014 dhe është kompensuar në emër të dëmit material dhe jo material në shumë prej 5.148,00 €, andaj pranimi i kësaj oferte, e privon atë nga e drejta e kompensimit të dëmit në procedurë përkatëse pranë gjykatës, ashtu siç është e përcaktuar në faqen e dytë, pasusin e fundit të marrëveshjes - ujdisë.

Nga të gjitha arsyet e cekura në arsyetim të këtij aktgjykimi të shkallës së dytë, Gjykatës së Apelit i rezulton se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga nenet 194, 195 paragrafi 1 pika (d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

Në një gjendje të tillë të çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës pranon si të bazuar qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë lidhur me refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit, pasi që aktgjykimi i të njëjtës gjykatë e as ai i gjykatës së shkallës së parë, nuk përfshihet me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore e as me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, në të cilat paditësi, thirret në revizion, e as me ato në të cilat gjykata e revizionit në kuptim të nenit 215 të Ligjit për Procedurë Kontestimore (LPK), kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Përndryshe në revizion vetëm në mënyrë të përgjithshme ky aktgjykim goditet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale nga neni 182.2 pika n, e LPK-së.

Gjykata Suprem e Kosovës gjeti se janë të pabazuara thëniet në revizion, përkitazi me shkeljet thelbësore të dispozitave procedurale nga neni 182.2, nënpika n e LPK-së. Kjo për shkak se gjykatat e instancave me të ulëta i janë përmbajtur në tërësi kërkesave të LPK-së, për

strukturën dhe përmbajtjen e aktgjykimit. Në aktgjykimin e shkallës së parë dispozitivi është i rregullt dhe në përputhje të plotë me arsyetimin e dhënë, ndërsa aktgjykimi i shkallës së dytë përmban arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha pretendimet e paraqitura në ankesë, përfshirë edhe shkeljet që shikohen sipas detyrës zyrtare. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse lidhur me mënyrën e vendosjes meritore të çështjes kontestuese. Në këtë kontekst, janë dhënë arsye bindëse me të cilat janë treguar faktet thelbësore të cilat janë marrë në vlerësim me rastin e vendosjes meritore, janë dhënë arsye për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e shfrytëzuara dhe për mënyrën e vlerësimit të provave të shfrytëzuara.

Sa i përket zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, gjykata e revizionit e aprovon qëndrimin e Gjykatës së Apelit se, në rastin konkret gjykata nuk mund të anuloj marrëveshjen-ujdinë e nënshkruar. Gjykata e shqyrtoi edhe pretendimin e revizionit se pala në procedurë nuk është përfaqësuar nga avokati. Në shkresat e lëndës ka prova se të paditurit, Këshillit Gjyqësor i Kosovës, kërkesa për kompensim të dëmit i është bërë nga paditësi përmes avokatit Avdi Rivanolli, të cilit padituri, KGK, i ka paguar kompensim për shpenzime të paraqitjes së kërkesës. Prandaj nuk qëndrojnë pretendimet se paditësi nuk e ka ditur mundësitë tjerë sepse nuk ka pas përfaqësues.

Sipas Gjykatës Supreme të Kosovës, kjo është në pajtim të plotë me nenin 13, pika 3 e Udhëzimit Administrativ 04/2015, për zbatimin e procedurës për kompensimin e dëmit për personat e dënuar ose të arrestuar pa arsye, pala mund të pajtohet me ofertën, të lidhë ujdi jashtëgjyqësore dhe kjo paraqet titull ekzekutiv, gjë që në rastin konkret është zbatuar. Vetëm nëse nuk pajtohet me ofertën e propozuar, ajo e nënshkruan mospajtimin dhe fiton të drejtën të kërkojë kompensimin e dëmit në procedurë gjyqësore.

Nga shkresat e lëndës, rezulton se paditësit para nënshkrimit të marrëveshjes për kompensim, i janë bërë të ditura të drejtat e tij, mirëpo i njëjti është dakorduar-pajtuar me shumën e ofruar, e të cilin veprim e ka bërë me vullnetin e tij, lidhur me përmbajtjen e ujdisë, në rastin konkret marrëveshja-ujdia është ligj për palët dhe e njëjta është zbatuar në tërësi dhe këtë fakt nuk e mohon as pala paditëse. Së këndejmi pretendimet e revizionit të paditësit, për zbatim të gabuar të së drejtës materiale u refuzuan si të pabazuara.

Pretendimet e paditësit përkitazi me konstatimin jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, Gjykata Supreme nuk i vlerësoi fare nga se për këtë shkak, në kuptim të nenit 214.2 të LPK, revizioni fare nuk mund të paraqitet

Krejt në fund, Gjykata Supreme gjen se me pretendimet e revizionit të paditësit nuk vihet në pyetje ligjshmëria e aktgjykimeve të lartpërmendura, në aspektin procedural dhe material të tyre, andaj në pajtim me nenin 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Rev.nr.172/2024 më datë 25.04.2024

Kryetari i Kolegjit  
Beshir Islami